



UNIVERSITETI I SHKODËRES

“Luigj Gurakuqi”

Rektori

Nr. 3234 Prot

Shkodër, me 23.09.2016

UDHEZIM *m 37/*

“Për procedurat e rekrutimit të pedagogëve me kohë të pjesshme në Universitetin e Shkodrës për vitin akademik 2016-2017”

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 57 pika 2, 64, 126 pika 5, statutit të Universitetit neni 36 dhe rregullores së zënies dhe ruajtjes së vendit të punës neni 10 dhe 22.

Udhëzoj:

1. Fillimin e procesit të rekrutimit për pedagogë me kohë të pjesshme.
2. Staf i pedagogëve me kohë të pjesshme do të përzgjidhet nga lista e gjithë aplikantave që kanë shprehur interes për të dhënë mësim në USH, nëpërmjet aplikimit on-line në faqen zyrtare të Universitetit.
3. Përzgjedhja e kandidatëve do të zhvillohet nga njësi bazë /Departamenti dhe do të monitorohet nga drejtuesi i njësisë kryesore / dekani i fakultetit.

Komisionet dhe përzgjedhja e kandidatëve.

4. Në njësi bazë/departamentet krijohen komisionet *Ad-Hoc*, me 3 deri në 5 anëtarë, anëtarët e komisionit propozohen nga Përgjegjësi i njësisë bazë / Drejtori i departamentit dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Kryetar i komisionit është drejtori i departamentit.
5. Komisioni *Ad-Hoc* deri me datë 27.09.2016 rendit aplikantët sipas kriterit të mesatares dhe mbledh dosjet e gjithë aplikantëve që kalojnë këtë kriter duke njoftuar me email secilin aplikant. Kopje e email-it të dërguar ruhet në departament dhe vendoset në dosjen e aplikantit. Aplikantët e njoftuar dorëzojnë dosjen për konkurim në Dekanatin përkatës brenda datës



29.09.2016. Kandidatët fitues që nuk dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar dosjet skualifikohen dhe zëvendësohen nga pasuesi në listë.

6. Aplikantët fitues që kanë qenë pjesë e stafit akademik me kohë të pjesshme në vitin e kaluar akademik, duhet të dorëzojnë vetëm dokumente për përditësimin e dosjes. Në dosje duhet të vendoset dhe vlerësimi me shkrim i departamentit për performancën e aplikantit.

Zhvillimi i konkurrimit dhe shpallja e rezultateve.

7. Dosjet shqyrtohen nga komisioni Ad-Hoc. Komisioni rendit fituesit sipas rradhës duke filluar nga më i miri (ai që rezulton me pikë më të larta) deri tek i fundit. Komisioni verifikon të dhënat e aplikantëve dhe skualifikon aplikantët që kanë deklaruar të dhëna jo të vërteta.
8. Konkursët zhvillohen nga data 30.09.2016 deri me datën 2.10.2016.
9. Renditja bazohet tek sistemi i pikëzimit të detajuar në rregulloren e zënies dhe ruajtjes së vendit të punës, të përditësuar nga departamenti. Sistemi i pikëzimit vlerëson performancën akademike dhe profesionale të kandidatit. Pas renditjes së konkurrentëve komisioni Ad-Hoc harton vendimin me fituesit që i përcillet dekanit përkatës.
10. Konkurentët fitues njoftohen nga kryetari i komisionit Ad-Hoc.
11. Listat e fituesve për pedagogët me kohë të pjesshme sipas çdo fakulteti dhe departamenti publikohet në faqen zyrtare të universitetit me datën 3.10.2016.

E drejta e ankimit

12. Konkurentët jofitues kanë të drejtë të paraqesin ankim te dekani i fakultetit. Ankimi duhet të paraqitet me shkrim brenda 2 ditëve nga shpallja e rezultatit.
13. Brenda 2 ditëve dekani shqyrton ankimet dhe merr vendim. Vendimi i dekanit duhet të jetë i arsyetuar dhe është i formës së prerë.
14. Pas procesit të ankimit drejtori i departamentit lidh akt – marrëveshjen për ngarkesën mësimore dhe afatin e punësimit. Akt-marrëveshja miratohet nga dekani i fakultetit. Dosjet e kandidatëve fitues së bashku me akt-marrëveshjen dërgohen tek dega e burimeve njerëzore deri me datën 10.10.2016.



15. Dega e burimeve njerëzore harton kontratat e punës të cilat nënshkruhen nga Rektori.
16. Kandidatët jofitues terheqin dosjet tek dekani përkatës.
17. Ngarkohen zv.rektori, dekanët, drejtorët e departamentit dhe dega e burimeve njerëzore për zbatimin e këtij udhëzimi.
18. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Rektori

Prof. dr. Adem BEKTESHI

